

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Dyshohet për sabotim/ Kaos në hekurudhat e Holandës, anulohet qarkullimi i trenave                                                                                                                                                                    |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/bota/dyshohet-per-sabotim-kaos-ne-hekurudhat-e-holandes-anulohet-qarkullimi-i-tr-i586233">https://www.gazetatema.net/bota/dyshohet-per-sabotim-kaos-ne-hekurudhat-e-holandes-anulohet-qarkullimi-i-tr-i586233</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHÀ


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 15 shtator 2026, 11:03:37 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 11:25:11 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | ec2b33a5c142f5bb79813a36c5a0d8f519777d53e2ecb75ad91ee6ce76c7fd8b |
| TEKSTI     | f179312fa9d29f11f414eb23d0c6121e8b9ac995f1083f427217fd5b89cf2a89 |
| PAMJA      | 8c613372084929b4c1157ab3657a7663e0deb5020c063028367edfb3f77ff322 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | ac8afda1543de99d657455669e38c5a0a9557b7278ed4f95fec4f9c5c4323909                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac8afda1543de99d657455669e38c5a0a9557b7278ed4f95fec4f9c5c4323909>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e [Direct Media shenon 25 vjet ne biznes/ Nga agjencia e pare mediatike deri te nje lider rajonal ne komunikimet e integruara](#) [Matthew Rhys ben histori ne Emmy Awards, t fundit](#)

## Dyshohet për sabotim/ Kaos në hekurudhat e Holandës, anulohet qarkullimi i trenave



15 Shtator 2026, 13:25 Bota TEMA



Një incident i dyshuar si sabotim ka shkaktuar ndërprerje të mëdha në trafikun hekurudhor në Holandë, duke prekur edhe Amsterdamin, ndërsa autoritetet kanë nisur hetimet për të zbuluar se kush qëndron pas vendosjes së qëllimshme të materialeve mbi shina.

Operatori holandez i infrastrukturës hekurudhore, ProRail, paralajmëroi se pasagjerët në pjesën qendrore dhe veriore të vendit duhet të përgatiten për anulime dhe vonesa të konsiderueshme gjatë së martës.

Problemet kanë prekur disa linja të rëndësishme, përfshirë ato drejt aeroportit ndërkombëtar Schiphol dhe qytetit të Utrechtit. Në të njëjtën kohë, disa kalime hekurudhore në nivel rruge kanë shfaqur probleme në funksionim.

Sipas mediave lokale, në disa pika të rrjetit hekurudhor janë gjetur tuba të vendosur mbi ose pranë shinave, transmeton Telegrafi.

ProRail deklaroi se në lokacione të ndryshme janë zbuluar materiale që ishin vendosur qëllimisht në shina, duke shkaktuar defekte në disa segmente të sistemit.

“Materialet u gjetën në disa pika të shinave dhe ishin vendosur qëllimisht aty. Kjo shkakton keqfunksionime në segmente. Duket se bëhet fjalë për sabotim”, deklaroi ProRail.

Kompania e përshkroi incidentin si një “ndërprerje të qëllimshme... të shkaktuar nga veprim njerëzor”.

Deri tani, autoritetet nuk kanë identifikuar persona të dyshuar dhe as motivin që mund të fshihet pas incidentit.

Njësisia kombëtare e policisë holandeze ka nisur hetimet për rastin, ndërsa autoritetet po përpiqen të përcaktojnë se kush i ka vendosur materialet në infrastrukturën hekurudhore dhe nëse incidentet në lokacione të ndryshme janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Pamjet e publikuara nga transmetuesi publik holandez NOS tregojnë policë pranë shinave në Veenendaal, në pjesën qendrore të vendit, duke transportuar atë që duket të jenë tuba metalikë rreth 1.5 metra të gjatë.

Faqja e rrjetit hekurudhor holandez raportoi 15 ndërprerje të ndryshme në të gjithë vendin gjatë së martës.

Pasojat janë ndier në disa prej linjave kryesore, duke prekur qarkullimin e trenave drejt zonave të banuara dhe nyjeve të rëndësishme të transportit.

ProRail u ka bërë thirrje udhëtarëve që të llogarisin kohë shtesë për udhëtimet e tyre, ndërsa hetimet vazhdojnë për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për një akt të koordinuar sabotimi apo për incidente të ndara.

Deri tani, autoritetet holandeze nuk kanë bërë të ditur nëse incidenti ka ndonjë lidhje me ndonjë grup apo aktivitet të huaj dhe as nuk kanë identifikuar një motiv të mundshëm.

 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

## Europa nuk e di më çfarë është

12:27 Bota

## Rekord historik në Japoni, mbi 100 mijë persona kanë kaluar moshën 100 vjeç

11:55 Bota

[Dasma e Trump Jr., oligarku rus i lidhur me Putinin pagoi qindra mijëra dollarë për festimet](#)

09:55 Bota / 2 komente

Trump njoftoi marrëveshje mes Ukrainës dhe Ruisë për të mos goditur objektivat energjetike, Zelensky: Jemi gati nëse Moska bën të njëjtën gjë

09:25 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.